



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, Nenin 25 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenin 49, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1. dhe Nenin 51, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185;
- Nenin 5 paragrafi 2 dhe nenin 21 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;

**në seancën e mbajtur me datë 12 mars 2014 nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I. APROVOHET** - Doracaku i Raportimit për Sektorin e Energjisë.

**A r s y e t i m**

- o ZRRE ka hartuar Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, i cili ka për qëllim që të udhëzojë të Licencuarin për mënyrën e raportimit në Zyrën e Rregullatorit për Energji, lidhur me pajtueshmërinë apo mos-pajtueshmërinë me dispozitat përkatëse të Licencave.
  - o ZRRE pas pranimit të komenteve të pranuar nga të licencuarit, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Me këtë vendimi shfuqizohet Doracaku i Raportimit për Sektorin e Energjisë, i miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 30.04.2010.
- III.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkangjitur:** Doracaku i Raportimit për Sektorin e Energjisë.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtar

---

Krenar Bujupi, anëtar